



Java e Kuzhinës Italiane në Botë Shqipëri, 13-19 nëntor 2023

Ambasada e Italisë në Tiranë, në bashkëpunim me Italian Trade Agency (ITA), Institutin Italian të Kulturës dhe Konsullatën e Përgjithshme në Vlorë, janë krenarë të lançojnë Edicionin VIII të Javës së Kuzhinës Italiane në Shqipëri, e cila do të mbahet nga data 13 deri në 19 nëntor 2023. Fushata vjetore kushtuar promovimit të kuzhinës italiane dhe produkteve agroushqimore përfshin një sërë aktivitete të cilat i drejtohen profesionistëve në këtë sektor si GDO, sektori Ho.Re.Ca, insitutet e kulinarisë dhe shkollat hoteleri-turizëm, gazetarë dhe institucione të sektorit.

Në tavolinë me kuzhinën italiane: mirëqënia me shije, kjo është tema e vitit 2023. Shqipëria do të marrë pjesë në Javën e Kuzhinës Italiane me iniciativa të fokusuar në promovimin jo vetëm të përsosmërisë së recetave dhe gastronomisë italiane, por edhe përfitimeve për shëndetin dhe mirëqenien.

Në kuadër të këtij projekti ITA do të organizojë një **Workshop** më 14 nëntor pranë Hotel Rogner në Tiranë, me qëllim thellimin e njohurive mbi ushqimin e shëndetshëm dhe dietën mesdhetare, si dhe mbi avantazhet e lidhura me shëndetin, aktivitetin sportiv dhe qëndrueshmërinë. shoqëruar me një degustim të produkteve tipike italiane si vaj ulliri dhe kafe.

Ndërsa më datë 15 nëntor do të mbahet **Lectio Magistralis Dieta Mesdhetare "trashëgimi e paprekshme": 66 vjet histori. Të ushqyerit dhe mirëqënia**. Aktivitetet realizohen në bashkëpunim me Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të mirë", Shoqatën Shqiptare të Shkencave të Ushqyerjes (ASNS), Confimi Industrie Albania dhe me mbështetjen e çmuar të Shoqatës Italiane të Sommelierëve (AIS).

Për më shumë informacione na ndiqni në rrjetet tona sociale:

Facebook: <https://www.facebook.com/iceagenziaalbania/>

Twitter: <https://twitter.com/itatirana>

Instagram: https://www.instagram.com/itatradeagency_tirana/

Web site: <https://italiantastealbania.com/>